



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:092620

Datë: 26.09.2024

Numri i dokumentit: 06215125

Ac.nr.4437/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Nehat Idrizi dhe Burim Shala, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit B.I. nga F.Rr.”G. S. të cilin me autorizim e përfaqëson avokatja E. H.-V. nga F. , kundër të paditurës “SN-A” SHPK me seli në F .Rr.”R.” me pronar A.L., të cilën me autorizim e përfaqësojnë E.R.dhe F.Z. avokat nga P., për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1133/17 të datës 07.07.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e paditësit B. I. nga F., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1133/17 të datës 07.07.2020, VERTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.1133/17 të datës 07.07.2020, ka vendosur si vijon:

- I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit B. I. nga F.Rr.”Gj. S.”, ushtruar kundër të paditurës “SN-A” SHPK me seli në F. Rr.”R.” me pronar A. L., lidhur me kompensimin e dëmit material në shumën prej 7,500.00 Euro në emër të ndërtimit nga ana e të paditurës në katin e ... (Pent-Haus) 1/3 të sipërfaqes prej 44 m2, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 964.80 Euro.
- II. DETYROHET paditësi B. I. nga F. Rr.”Gj. S.” që t’ia paguaj të paditurës “SN-A” SHPK me seli në F.Rr.”R.” me pronar A. L. shpenzimet e procedurës në shumën prej

743.60 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi përmes përfaqësueses së autorizuar, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit të prishet aktgjykimi i atakuar ndërsa lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

E paditura ka parashtruar përgjigje në ankesë, përmes së cilës i ka kontestuar në tërësi si të pabazuara pretendimet ankimore të paditësit, duke theksuar se aktgjykimi i atakuar nuk përfshihet me shkeljet e pretenduara të dispozitave procedurale, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është në harmoni me arsyetimin e tij. Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, gjersa nga provat vendimtare ka rezultuar se kontrata e lidhur mes palëve ndërgjyqëses për ndërtimin e përbashkët është përmbushur në tërësi, përkatësisht detyrimet e ndërsjella nga kontrata dhe aneks kontrata janë përmbushur në mënyrë vullnetare, ashtu që paditësit nuk i është shkaktuar asnjë lloj dëmi, prandaj kërkesa kërkesëpadija për shpagimin e dëmit, me të drejtë nga gjykata e shkallës së parë është refuzuar si e pabazuar. Nga arsyet e parashtruara, ka propozuar që ankesa e paditëses të refuzohet dhe të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr. 1133/2017, dt. 27.07.2020.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 26.12.2017, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit, kundër të paditurës me arsye dhe kërkesë si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1133/17, të datës 07.07.2020, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka parashtruar se për të vërtetuar bazueshmërinë e kërkesëpadiisë si dhe gjendjen e plotë të fakteve për të vendosur drejtë në këtë çështje juridike kontestimore, ka administruar provat dhe atë: Kontratën për ndërtimin e përbashkët-bashkëinvestim LRP.nr.3475/2015 e datës 11.08.2015, Marrëveshjen jo formale të lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse me datë 14.08.2015, Aneks kontratën për ndërtimin e përbashkët-bashkëinvestim LRP.nr.1149/2016, Ekspertizën gjeodezike, dt.02.12.2019 të hartuar nga M. L., gjeodet i licencuar dhe Ekspertizën e ndërtimtarisë dt. 27.01.2020 të hartuar nga

eksperti F. M.. Nga provat e nxjerra gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret ka shuarje të marrëdhënieve të detyrimit në mënyrë vullnetare, me përmbushjen e detyrimit nga ana e të paditurës në procedurën jashtëgjyqësore përmes kontratës për bashkëinvestim dhe aneksin e saj. Pra, paditësi ka realizuar në tërësi të drejtat e tij që burojnë nga këto punë të vlefshme juridike, fakt jo kontestues ndërmjet palëve ndërgjyqëse. Ka shtuar se shuarja e detyrimeve me përmbushje (ekzekutimi, pagesa) është mënyra më e natyrshme e realizimit të të drejtave dhe detyrimeve nga palët kontraktuese. Meqë detyrimi është përmbuhur në tërësi, prandaj edhe është arritur qëllimi i detyrimit.

Gjykata e shkallës së parë, gjithashtu ka vlerësuar se paditësi nuk mund të kërkojë të drejta, në të cilat nuk i ka të legjitimuar as vetë e paditura, për aqsa se kati i nëntë është ndërtuar pa leje ndërtimore. Paditësi nuk mund të thirret në paligjshmëri të tjetrit në këtë rast të paditurës. Kërkesa e paditësit për kompensimin e dëmit për shkak se e paditura ka ndërtuar në katin e nëntë pa leje, nuk ka mbështetje ligjore, duke marrë edhe parasysh faktin se paditësi tani nuk është pronar i parcelës me numër 330-5, të cilën sipas kontratës për bashkëinvestim të drejtën e pronësisë ia ka bartur të paditurës, ndërsa kjo e fundit këtë parcelë dhe të tjerattë gjitha i ka bartur në emër të saj dhe i ka bashkuar duke marrë numër të ri kadastral F., me sipërfaqe prej 1,735 m2. Përmes provave vendimtare ka rezultuar se paditësi nuk ka të drejta të drejta tjera sendore në këtë parcelë, përpos atyre të realizuara në pjesën e ndërtesës të cilat janë pranuar sipas punës së vlefshme juridike, të cilat të drejta i ka realizuar në tërësi, prandaj edhe pretendimi për dëmin e shkaktuar dhe kërkesa për shpëtimin e dëmit është e pabazuar.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 136; 137; 169 dhe 175 të LMD-së, neni 5 dhe 18 i LPDTS; Kushtetutës së Republikës së Kosovës nenet: 22; 46 dhe 121 dhe Protokollin Shtesë i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore neni 1.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit, kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2, pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë, i ekzaminueshëm dhe në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Sipas Gjykatës së Apelit, të paqëndrueshme janë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të vërtetuar, pasi që me vlerësimin e shkresave të lëndës, rezulton se në këtë rast gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike,

gjegjësisht ka vërtetuar se në rastin konkret, marrëdhënia e detyrimeve është shuar në mënyrë vullnetare përderisa mbi bazën e kontratës për bashkëinvestim dhe aneksin e saj, paditësi ka realizuar në tërësi të drejtat e tij që burojnë nga këto punë të vlefshme juridike. Në anën tjetër, nga përmbajtja e kontratës LRP.nr. 3475/2015, dt. 11.08.2015; marrëveshja joformale e lidhur mes ndërgjyqësve me datë 14.08.2015 dhe aneks kontrata për ndërtimin e përbashkët-bashkëinvestim LRP. Nr. 1149/2016, datë 29.09.2016, nuk ka rezultuar që paditësi të ketë rezervuar të drejtën që të kërkoj realizimin e ndonjë të drejte tjetër eventuale nga e paditura, përpos atyre të dakorduara si në kontratë. Për më tepër, në paluajtshmërinë, në drejtim të së cilës kërkohet shpagimi i dëmit, të drejtat në pronë i janë bartur të paditurës, ashtu siç rezulton nga ekspertizat e nxjerra në këtë çështje kontestimore.

Kështu, meqë është vërtetuar që paditësi të drejtat e përcaktuara sipas kontratës për bashkëinvestim, i ka realizuar në tërësi, ndërsa kërkesa për shpagimin e dëmit, nuk legjitimohet nga asnjë provë e besueshme në këtë drejtim, për këtë arsye nga kjo gjendje e fakteve, gjykata ankimore vjen në përfundim se vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë që kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar është rezultat i hetimit të plotë të fakteve dhe provave vendimtare, në raport me të cilat gjykata e çështjes drejtë ka zbatuar ligjin material, duke vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë me zbatim të drejtë të dispozitës nga neni 452 të LPK, pasi paditësi e ka humbur kontestin.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 194, 195 parag1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4437/20, me datë 10.09.2024

Kryetare e kolegjit
Hunaida Pasuli